



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM MBI REZULTATET E INTERVISTËS PËR PROCEDURËN E
KONKURRIMIT TË LËVIZJES PARALELE PËR KATEGORINË E ULËT
DREJTUESE**

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 242 datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive njofton se:

Në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, kandidati i kualifikuar për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të shpallura për konkurrim, për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit, Drejtoria e Mbikëqyrjes - Kategoria e pagës III-a, nuk u paraqit në ditën dhe datën e caktuar të intervistës.

Ky pozicion është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga kategoria paraardhëse për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Autoriteti i Mediave Audiovizive